

REPUBLIKA E KOSOVËS - VLADE KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
 ZIKRARI QENDRORE - UREDE PREMTERE - OFFICE OF THE PRIME MINISTER
 SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARKIVE - ARCHIVE SECTOR

Mesazhi dhe
 Objektiviteti
 Ora/Unit 01

Nr. Doku
 Pro. No. 025

Nr. Fletëve
 Nr. Stranica
 No. pages PO

Data:
 Datum: 08/01/2021
 Data: 08/01/2021

Prishtinë/Prishtina



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
 Centralna Izborna Komisija
 Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Data/Datum 08.01.2021 *Ref. Nr.*

z. Avdullah Hoti, Kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës
 Znj. Hykmete Bajrami, Ministre në Ministrinë e Financave dhe Transfereve

Për/Za Fitim Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit

Nga/Od Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Kopje/Kopija Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit MFT, Arkivës

Lënda/Predmet Kërkesë për ndarjen e Buxhetit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës 2021

Të nderuar

Në Ligjin nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, buxheti i aprovuar nuk është i mjaftuar për organizimin e dy palë zgjedhjeve. Fillimisht në këtë buxhet është planifikuar buxheti për zgjedhjet lokale por jo edhe ato të parakohshme parlamentare.

Pas shpalljes së datës 14 shkurt 2021 për mbajtjen dhe organizimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në takimin e mbajtur më 7 janar 2021 aprovoi buxhetin për organizimin dhe mbajtjen e tyre.

Buxheti i aprovuar për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend të Kosovës është në vlerë prej 5,578,712 euro.

Pasi zgjedhjet parlamentare nuk ishin planifikuar të mbahen në vitin 2021, në Ligjin nr. 07/L-041 Mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 nuk ka buxhet të aprovuar për këtë qëllim.

Sipas praktikave të më hershme, duke filluar nga viti 2010, 2014, 2017 dhe 2019 për zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës, kur nuk kishte buxhet të aprovuar për mbajtjen dhe organizimin e tyre, Qeveria e Republikës së Kosovë i ka ndarë buxhetin KQZ-së për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve.

Në pajtim me nenin 66.8 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, KQZ-ja ka përgatit kërkesë Qeverisë së Republikës së Kosovës për buxhet të veçantë për këtë proces zgjedhor.

Duke pasur parasysh se në Ligjin e buxhetit nr. 07/L-041, nuk ishin të parashikuara shpenzimet për organizim dhe mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme, vendimin e shpalljes sipas nenit 29 i ligjit 03/L-048 Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, KQZ-ja kërkon fonde shtesë për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve.

Andaj nëpërmjet kësaj shkrese, ju drejtohem me kërkesë, që sa më parë të i ndahet KQZ-së dhe të alokohet buxheti për Zgjedhje të Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës.

Çdo vonesë e ndarjes dhe alokimit të buxhetit do të ndikojë drejtpërdrejt në mbarëvajtjen dhe organizimin e procesit zgjedhor e të cilat pasoja nuk do të i bartë KQZ-ja.

Sipas programeve dhe kategorive ekonomike, kërkesa buxhetore e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për mbajtjen dhe organizimin e Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Kosovës është:

Programet	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Shpenzime kapitale	Total
Sekretariati	97,620				97,620
Zgjedhjet		5,315,242	22,250	143,600	5,481,092
KQZ-Total	97,620	5,315,242	22,250	143,600	5,578,712

Shuma e planifikuar e buxhetit në vlerë prej 5,578,712 do të shpenzohet për shërbime, furnizime dhe prodhimin e materialit zgjedhor si:

- Fletëvotime, listës komunale të votuesve, forma zgjedhore,
- Furnizimin me material sensitiv dhe jo sensitiv;
- Transportin e materialit sensitiv dhe jo sensitiv;
- Trajnimin e Këshillave të Vendvotimit;

- Pagesat për anëtarët e këshillave të vendotimeve dhe stafit tjetër ndihmës, për Komisionin Komunal Zgjedhor dhe trajnerët e angazhuar në këtë proces;
- Pagesat e stafit të angazhuar në Sekretariat si dhe angazhimi i stafit ditor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, stafi i K-vote si dhe aktiviteteve tjera të cilat janë planifikuar me Planin Operacional për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës.

Duke u mbështetur në nevojat për fonde shtesë, KQZ-ja kërkon që të lejohen fondet e kërkuara sipas programeve dhe kategorive ekonomike për mbajtjen dhe organizimin e zgjedhjeve.

Të bashkangjitur me këtë shkresë gjeni:

- *Vendimin për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme Nr. 02/2021 të datës 06.01.2021;*
- *Vendimin e KQZ-së me Nr. 16/2021 të datës 07.01.2021 për miratimin e Buxhetit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës*
- *Planin e Buxhetit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës 2021*

Signjali



Nr. 02/2021

U.d. Presidentja e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 84 pika (3), nenit 90 dhe nenit 95 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 47, 25 janar 2009), nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L – 073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (GZ, Nr. 31, 15 qershor 2008), nenit 3 (4) të Rregullores (P) Nr. 02/2016 për Strukturën Organizative të Presidencës (08.09.2016) dhe duke marrë parasysh Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin nr. KO95/20 (Nr. ref.: AGJ 1692/21, datë: 06 janar 2021), si dhe pas konsultimeve përkatëse, nxjerr:

V E N D I M

Për caktimin dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës

1. Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës do të mbahen më 14.02.2021.
2. Udhëzohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në përputhje me këtë vendim dhe legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Vjosa Osmani - Sadriu

u.d. Presidente e Republikës së Kosovës

Prishtinë, 06.01.2021.

Vendimi t'i dërgohet:

- Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës;
- a/a.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 115.1 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe duke u bazuar në vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës, Nr.09/2021 i dates 07.01.2021, për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 07.01.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Planit të Buxhetit për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvendin e Kosovës

- I. Miratohet Plani i Buxhetit dhe buxheti shtesë, për zgjedhjet e parakohëshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më 14.02.2021.
- II. Plani i Buxhetit si në pikën I të këtij vendimi, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 07.01.2021

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Valdete Daka



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Sinjali

BUXHETI

PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVEND TË KOSOVËS

Prishtinë, 7 janar 2021

Përkufizimet

KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
SKQZ	Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
MF	Ministria e Financave
LMFPP	Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
BBK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
KKZ	Komisioni Komunal i Zgjedhjeve
QNR	Qendra e Numërimit dhe Rezultateve
QV	Qendra e Votimit
VV	Vend Votimi
KVV	Këshillat e Vend Votimit
€	Euro
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik

Përkufizimet.....	2
HYRJE.....	4
PLANI I BUXHETIT PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVEND TË KOSOVËS	5
1. PAGA DHE MËDITJE.....	6
2. MALLRA DHE SHËRBIME.....	6
2.1. Angazhimi i stafit të përkohshëm.....	6
2.2. Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ).....	6
2.3. Trajnerët.....	7
2.4. Këshillat e vendotimeve (KVV-të).....	7
2.5. Zyra për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike.....	7
2.6. Departamenti i Operacioneve të Zgjedhjeve.....	8
2.8. Qendra e Numërimit dhe Rezultateve.....	10
2. SHPENZIME KOMUNALE.....	10
3. SHPENZIME KAPITALE.....	10
<i>Shtojcë:</i>	11
Buxheti për zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës 2021.....	11

HYRJE

Në Ligjin nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, buxheti i aprovuar nyk është i mjaftuar për organizimin e dy palë zgjedhjeve. Fillimisht në këtë buxhet është planifikuar buxheti për zgjedhjet lokale por jo edhe ato parlamentare.

Pas publikimit dhe shpalljes së datës 14 shkurt 2021 për mbajtjen dhe organizimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka hartuar dhe aprovuar buxhetin për zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës.

Në bazë të planit të buxhetit për organizim dhe mbajtje të këtyre zgjedhjeve dhe duke u bazuar në nenin 66.8 i Ligjit për Zgjedhjet, KQZ-ja ka përgatit kërkesën për buxhet të veçantë për fonde shtesë.

Po ashtu, bazuar në nenin 29 i ligjit 03/L-048 Ligjit të menaxhimit tëë Financave Publike dhe Përgjegjësitë, në rast të mungesës së buxhetit i cili nuk është i aprovuar me Ligj të Buxhetit, KQZ-ja mund të aplikojë pranë Ministrit të MF për fonde shtesë.

Bazë për planifikimin e buxhetit kanë shërbyer analizat e shpenzimeve të realizuara në zgjedhjet e fundit të vitit 2019, në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme të mbajtura këtë vit për kryetar në dy komuna për Kuvend të Kosovës, si dhe planifikimi i buxhetit për organizimin dhe mbajtjen e Zgjedhjeve Lokale në vitin 2021.

Buxheti është planifikuar në nivel të programeve dhe konform kërkesave të njësive kërkuese dhe projekteve për organizimin e zgjedhjeve parlamentare. Përveç që buxheti është planifikuar në nivel të programeve, planifikimi është bërë në nivel të kategorive ekonomike, përkatësisht të zërave duke respektuar legjislacionin financiar, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik dhe në përputhje me strukturën egzistuese të planit kontabël.

PLANI I BUXHETIT PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVEND TË KOSOVËS

Ndër aktivitetet e para pas shpalljes së datës për mbajtjen e zgjedhjeve është vlerësimi dhe shqyrtimi i kërkesave buxhetore sipas njësive.

Mbi bazën e këtyre kërkesave është planifikuar dhe përgatitur buxheti për zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës.

Buxheti i planifikuar për zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës është në shumë prej 5,578,712 euro.

Në programin e Sekretariatit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve buxheti i planifikuar ka vlerën prej 97,620 euro. Ky buxhet do të shfrytëzohet për pagesën e shtesave të zyrtarëve të angazhuar me orar të zgjatur të punës si dhe për angazhimet e tyre edhe ditëve të vikendit.

Buxheti i planifikuar në programin e Zgjedhjeve është në vlerë prej 5,481,092 euro nga i cili në mallra dhe shërbime 5,315,242 euro, shpenzime komunale 22,250 euro dhe shpenzime kapitale 143,600.00 euro. Buxheti planifikohet të shpenzohet për të gjitha shërbimet dhe furnizimet e procesit zgjedhor.

Në euro			
Kategorit ekonomike	Sekretariati	Zgjedhjet	Total KQZ
Pagat dhe Mëditje	97,620		97,620
Mallra dhe shërbime		5,315,242	5,315,242
Shpenzime Komunale		22,250	22,250
Shpenzime Kapitale		143,600	143,600
Total	97,620	5,481,092	5,578,712

Tabela 1. Buxheti i planifikuar për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend

Sipas kategorive ekonomike, buxheti ka këtë strukturë:

Në euro					
Programet	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime Komunale	Shpenzime kapitale	Total
Sekretariati	97,620				97,620
Zgjedhjet		5,315,242	22,250	143,600	5,481,092
KQZ-Total	97,620	5,315,242	22,250	143,600	5,578,712

Tabela 2. Buxheti i planifikuar sipas programeve dhe kategorive ekonomike

1. PAGA DHE MËDITJE

Buxheti ne kategorinë për paga dhe mëditje është planifikuar ne shume prej 97,620 euro i cili buxhet është planifikuar për angazhimet shtesë për anëtarët e KQZ-së dhe për stafin e SKQZ-së. Organizimi i zgjedhjeve brenda një afati shumë të shkurtë kohor, patjetër kërkon qe edhe stafi të angazhohet më gjatë se orari i rregullt te punës. Është vlerësuar se për këtë periudhë të shkurtë të organizimit të zgjedhjeve është e pa mundur me angazhim të stafit dyzet orë shtesë në muaj të përmbushen objektivat dhe të realizohet Plani Operacional për zgjedhjet parlamentare. Shtesat janë planifikuar për stafin dhe anëtarët e KQZ-së të angazhuar drejtpërdrejtë në proces zgjedhor.

2. MALLRA DHE SHËRBIME

Shuma e planifikuar e mjeteve buxhetore ne mallra dhe shërbime ne shume prej 5,315,242 euro e cila paraqet 95,30 % të buxhetit për zgjedhje. Buxheti i planifikuar në këtë kategori ka të bëjë me:

- prodhimin e materialit zgjedhor (fletëvotimeve, listës komunale te votuesve, formave zgjedhore,
- furnizimin me material sensitiv,
- transportin e materialit zgjedhor,
- pagesat e anëtarëve te Këshillave te vendvotimeve dhe stafit tjetër ndihmës, e trajnerve angazhuar dhe për komisionin komunal zgjedhor,
- pagesat për stafin e angazhuar gjatë procesit zgjedhor në Sekretarit,
- pagesat e stafit te angazhuar ne Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve si dhe
- aktivitet e tjera të planifikuara me planin operacional.

2.1. *Angazhimi i stafit të përkohshëm*

Për zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës, në pajtim me nevojat dhe kërkesat janë planifikuar se do te angazhohen 402 zyrtarë përkohësisht dhe për angazhimin e tyre janë planifikuar mjete në shumë prej 363,172.43 euro.

2.2. *Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ)*

Në bazë të ligjit mbi Zgjedhjet Nr. 03 /L-073, përkatësisht bazuar në nenit 69, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bëhet emërimi i anëtarëve të Komisioneve Komunale Zgjedhore

Për zgjedhjet e parakohshme janë planifikuar të emërohen 266 anëtarë në Komisionet komunal zgjedhore të cilët do të angazhohen për 3 muaj dhe janë planifikuar mjete buxhetore në vlerë prej 386,232 euro.

2.3. Trajnerët

Në zgjedhjet e parakohshme për janë planifikuar të angazhohen 274 trajnerë për dy muaj dhe buxheti i planifikuar është 248,655.00 euro.

2.4. Këshillat e vendvotimeve (KVV-të)

Ligji mbi Zgjedhjet, përkatësisht neni 74 i këtij ligji përcakton kriteret dhe mënyrën e emërimit të anëtarëve të KVV-ve. Gjithashtu neni 78 i Ligjit mbi zgjedhjet përcakton edhe formën e pagesës së tyre.

Në zgjedhjet e parakohshme do të angazhohen gjithësej 29,075 anëtarë të KVV-ve si dhe personel tjetër ndihmës. Për angazhimin e tyre janë planifikuar 2,500,155euro.

Pozita	Rundi	Mëditja	Numri	Ditët	shuma
Kryesues i Vendvotimit	1	45	2700	3	364,500.00
Anëtarët e Vendvotimit	1	30	16800	3	1,512,000.00
Anëtar Rezervë të Vendvotimit	1	22.5	2925	2	131,625.00
Zyrtar i Tavolinës Ndihmëse	1	18	2100	2	75,600.00
Menaxher të Qendrës së Votimit	1	26.5	950	3	75,525.00
Asistent të QV-ve	1	16	1900	2	60,800.00
Punëtor Fizik	1	15	150	2	4,500.00
Pronar të kombibues	1	50.5	1550	2	156,550.00
Kontributet Pensioneve të Punëdhënësit			29075		119,055.00
Total					2,500,155.00

Tabela 3. Këshillat e vendvotimeve

2.5. Zyra për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike

Zyra ka bërë kërkesën buxhetore për Zgjedhjet e parakohshme në shumë prej 68,525 për:

Përshkrimi	Sasia	Çmimi	shuma në €
Tërheqja e Shortit (Baner)	1.00	100.00	100.00
Tërheqja e Shortit (Ushqim dhe Pije)	1.00	500.00	500.00

Salla e takimit	1.00	500.00	500.00
Paisje perkthimi	1.00	200.00	200.00
Distinktivë për Vëzhgues (komplet=kartela, mbajtesja dhe lidhesja)	40,000.00	1.20	48,000.00
Broshura për Vëzhgues në 3 gjuhë	40,000.00	0.15	6,000.00
Ridestininim i videos informuese (dy gjuhë)	2.00	700.00	1,400.00
Transmetim i videos**(20)	2.00	50.00	2,000.00
Programi për Vëzhgues të huaj	1.00	2,000.00	2,000.00
Përkthim Shqip-Gj.Turke-Gj. Rome	1.00	500.00	500.00
Roll-up banner për Zyrë	1.00	130.00	130.00
Tavolina paluese 42x60 cm	10.00	25.00	250.00
Laptop	10.00	500.00	5,000.00
Projektor	1.00	500.00	500.00
Kamerë për kyqje online (Conference Cam)	1.00	500.00	500.00
Disk i jashtëm SSD 500 GB (external disk)	1.00	99.00	99.00
Folder (skedar të mesëm)	48.00	1.50	72.00
Leter A4 (pako x 500)	15.00	5.00	75.00
Kuti paketimi (që palohen)	15.00	1.00	15.00
DVD Rewritable	48.00	0.50	24.00
Skaner me feeder (i shpejt)	1.00	500.00	500.00
Toner	2.00	80.00	160.00
Totali			68,525.00

2.6. Departamenti i Operacioneve të Zgjedhjeve

Buxheti i planifikuar i Departamentit të operacioneve të zgjedhjeve është në shumë prej 493,260.00 euro. Ky buxhet ka të bëjë me Shtypjen e listës votuese, projektin për të verbërit dërgesat postare informimi publikvotimi jashtë Kosove, pako dhe doracak trajnimi:

Shtypja e Listave Përfundimtare të Votuesve	37,800.00
Shtypja e Listave Komunale të Votuesve	32,400.00
Shtypja e Lista Preliminare të Votuesve	2,300.00
Projekti për të Verbëritë	32,000.00
Dërgesat postare	80,000.00
Materiale administrative	7,500.00
Zarfet për Operacionin e Votimit jashtë Kosovës	9,000.00
Akomodimi/ushqimi (12 staf për mbikëqyrje LPV LVK 8 dite	5,760.00
Strategjia e informimit publik	220,000.00
Pako trajnimi	37,500.00
Doracak te trajnimit	15,000.00
Ushqim dhe pije për trajnim	14,000.00
Total	493,260.00

Tabela 4. Materiale zgjedhore

2.7. Fletëvotimet

Për prodhimin e 1,900,000 fletëvotimeve dhe broshurave dhe shpenzime tjera për proces zgjedhor buxheti i planifikuar është në shumë prej 197,358 euro.

Dizajn dhe Printim	Sasia	Çmimi	shuma ne €
Shtypja e fletëvotimeve për Kuvendin e Kosovës	1900000	0.0938	178,220.00
Shtypja e broshurave të kandidatëve	29000	0.572	16,588.00
Shërbime të cloud hosting dhe mekanizma tjerë	3	850	2,550.00
Totali			197,358.00

2.8. Qendra e Numërimit dhe Rezultateve

Qendra e Numërimit dhe Rezultateve gjendet ne zonën Industriale ne Fushë Kosovë për te cilën janë planifikuar mjete buxhetore me qëllim te përgatitjes dhe te përmbushjes se standardeve për numërimin e votave. Buxheti i QNR-së është 184,020 euro i cili është planifikuar për:

Qendra e Numërimit dhe Rezultateve	Sasia	Çmimi	shuma ne €
Material Higjienik			950.00
Riparimi i rrymës, ndriçimit, tualeteve, hapësirës se Bufesë, furnizimi me poqa elektrik			500.00
Dezinfektimi, Dezinfektimi dhe Deratizimi i objektit te QNR-se			780.00
Detektor, dyer metalike për kontrollim	2	600	2,400.00
Xhama plastik për distance fizike - masat COVID-19			20,000.00
Modifikimi dhe përkrahja teknike për softuerin e operimit të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve & Modifikimi dhe përkrahja teknike për softuerin e rezultateve preliminare, dhe shërbimet tjera & Modifikimi dhe përkrahja teknike për aplikacionin për ndërrimin e qendrës së votimit dhe makinës kërkuese			140,000.00
SMS (4 pako me nga 3000 SMS për informim te stafit)			600.00
Mbushje të telefonisë mobile për mirëmbajtje			90.00
Makinë për pastrimin e dyshemesë	1	3600	3,600.00
Fshesë Elektrike			100.00
Autobus (50 ulëse) për staf ditor			15,000.00
Totali			184,020.00

Tabela 5. Qendra e Numërimit dhe Rezultateve

2. SHPENZIME KOMUNALE

Gjatë periudhës së zgjedhjeve për shpenzime komunale janë planifikuar 22,250 euro, prej të cilave 20,000 euro për shpenzime të energjisë elektrike duke e përfshirë depon, zyre me qira dhe Qendrën e Numërimit, 250 euro telefoni fikse dhe 2,000 euro per mbeturina.

3. SHPENZIME KAPITALE

Buxheti për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës ne kategorinë e shpenzimeve kapitale planifikohet të jetë në vlerë prej prej 143,600.00 euro.

Për Modifikim dhe përkrahje teknike për softuerin e operimit të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve & Modifikim dhe përkrahje teknike për softuerin e rezultateve preliminare, dhe shërbimet tjera & Modifikim dhe përkrahje teknike për aplikacionin për ndërrimin e qendrës së

votimit dhe makinës kërkuese janë planifikuar 140,000.00 euro, dhe Makinë për pastrimin e dyshemesë ne shume prej 3,600.00 euro.

Ndërkaq për Aparat për evidencat e hyrje-dalje të stafit të QNR janë planifikuar 3,500,00 euro.

Shtojcë:

Buxheti për zgjedhjet e parakohshme 2021 sipas kategorive ekonomike

Stafi i përkohshëm dhe ditor i angazhuar në proces zgjedhor 2021

Buxheti për zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës 2021
sipas kategorive ekonomike

KODI	LINE ITEM (SHPENZIM)	Plani i Buxhetit për Zgjedhje 2021
320	TOTAL BUXHETI	5,578,712.05
11	RROGAT DHE PAGAT	97,620.15
111	RROGAT MUJORE ME ORAR TË PLOTË	97,620.15
1110	RROGAT MUJORE ME ORAR TE PLOTE	97,620.15
11110	Pagat Neto përmes listës se pagave	79,490.69
1150	TATIMI I NDALUR NE BURIM NE TE ARDHURA PERSONALE	8,832.30
11500	Tatim I ndalur në burim në të ardhura personale	8,832.30
1160	KONTRIBUTI PENSIONAL NGA PUNETORI	4,648.58
11600	Kontributi pensionet nga punëtori	4,648.58
1170	KONTRIBUTI PENSIONAL NGA PUNEDHENESI	4,648.58
11700	Kontributi pensionet nga punëdhënësi	4,648.58
13	MALLRA DHE SHËRBIME	5,315,241.90
130	MALLRA DHE SHËRBIME	5,315,241.90
1310	SHPENZIMET E UDHËTIMIT	29,260.00
13130	Shpenzimet e Udhëtimit zyrtar brenda vendit	15,000.00
13132	Akomodimi gjate udhëtimit zyrtar brenda vendit	5,760.00
13140	Shpenzimet e Udhëtimit zyrtar jashtë vendit	2,500.00
13141	Mëditja e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	2,500.00
13142	Akomodimi gjate udhëtimit zyrtar jasht vendit	2,500.00
13143	Shpenzimet tjera te udhëtimit zyrtar jashtë vendit	1,000.00
1330	SHËRBIMET E TELEKOMUNIKIMIT	92,600.00
13310	Shpenzimet per internet	2,550.00
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	10,050.00
13330	Shpenzimet postare	80,000.00
1340	SHPENZIMET PER SHËRBIME	3,887,008.90
13450	Shërbime shtypje- jo marketing	15,000.00

13460	Shërbime Kontraktuese Tjera	3,872,008.90
1350	BLERJE E MOBILJEVE DHE PAISJEVE (ME PAK SE 1000 EURO)	6,899.00
13503	Kompjuterë (me pak se 1000 euro)	5,000.00
13504	Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro)	99.00
13505	Makina fotokopjuese (me pak se 1000 euro)	500.00
13509	Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)	1,300.00
1360	BLERJE TJERA - MALLRA DHE SHERBIME	959,254.00
13610	Furnizime për zyrë	955,304.00
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	3,000.00
13640	Furnizime pastrimi	950.00
1370	DERIVATET DHE LËNDËT DJEGËSE	8,000.00
13770	Derivate për gjenerator	3,000.00
13780	Karburant për vetura	5,000.00
1400	MIRËMBAJTJA	21,200.00
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	6,760.00
14020	Mirëmbajtja e ndërtesave	13,280.00
14040	Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative	160.00
14050	Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve	1,000.00
1410	QIRAJA	60,890.00
14110	Qiraja për ndërtesa	57,500.00
14130	Qiraja për pajisje	2,400.00
14140	Qiraja për makineri	990.00
1420	SHPENZIMET E MARKETINGUT	223,400.00
14230	Shpenzimet për informim publik	223,400.00
1430	SHPENZIMET E PËRFAQËSIMIT	21,600.00
14310	Drekat zyrtare	21,600.00
1450	TATIMI	5,130.00
14510	Pagesa e tatimit ne qira	5,130.00
14	SHPENZIMET KOMUNALE	22,250.00
132	SHPENZIME KOMUNALE	22,250.00
1320	SHPENZIME KOMUNALE	22,250.00
13210	Rryma	20,000.00
13230	Mbeturinat	2,000.00
13250	Shpenzimet telefonike	250.00
30	PASURITË JOFINANCIARE	143,600.00
300	PASURITË JOFINANCIARE	143,600.00
3160	PAISJE (SIST.VLERA MBI 1000 EURO)	143,600.00
31680	Souftver	140,000.00
31690	Pajisje Tjera	3,600.00

Lista e Stafit jopermanent per zgjedhjet e parakoheshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës

Pozita	Koeficienti	Vlera e koefic.	Numri	Muajt	Totali
Asistent/e i/e Anëtarit të KQZ-së	6	60.5	11	2	7,986.00
Zyrtarë i/e i Personelit	8	60.5	2	2	1,936.00
Zyrtar i Përkthimit shqip serbisht anasjelltas	7	60.5	1	2	847.00
Zyrtar i Përkthimit shqip anglisht - anasjelltas	7	60.5	1	2	847.00
Zyrtar i Arkives	7	60.5	1	2	847.00
Asistent i Drejtorit të DAP-it	6	60.5	1	2	726.00
Zyrtar për Buxhet dhe Financa	8	60.5	4	2	3,872.00
Menagjer i Depos	8	60.5	1	2	968.00
Zyrtar i Logjistikes/Depo	7	60.5	4	2	3,388.00
Zyrtar i Logjistikes/SKQZ	7	60.5	4	2	3,388.00
Nëpunës për Depo	6	60.5	27	2	19,602.00
Shofer/SKQZ	6	60.5	10	2	7,260.00
Zyrtar të Teknologjise Informative	8	60.5	10	2	9,680.00
Zyrtar i Sherbimit votuese	8	60.5	4	2	3,872.00
Zyrtar të Listes Votuese	7	60.5	116	2	98,252.00
Asistent i drejtorit të DOZ-it	6	60.5	1	2	726.00
Zyrtar i Informimit Publik	7	60.5	6	2	5,082.00
Zyrtar të Trajnimit	8	60.5	25	2	24,200.00
Zyrtar i Prokurimit	9	60.5	2	2	2,178.00
Zyrtar Ligjor	7	60.5	3	2	2,541.00
ZV Udhëheqës i QNR-se	9	60.5	1	2	1,089.00
Zyrtar të Trajnimit, udhëheqës të ekipit	8	60.5	41	2	39,688.00
Zyrtar për marrdhenje me jashtë, nëpunës i logjistikes, Administrim i Objektit)	7	60.5	35	2	29,645.00
Mirëmbajtës të Objektit	5	60.5	4	2	2,420.00
Udhëheqës i Ekipit të Koordinimit në Terren	8	60.5	1	2	968.00
Zyrtar i Koordinimit në Terren	7	60.5	12	2	10,164.00
Zyrtar/e Ekzekutive i/e Drejtorit Ekzekutiv të ZRPPC	7.5	60.5	1	2	907.50
Zyrtar/e i/e Lartë në ZRPPC	8	60.5	8	2	7,744.00
Zyrtar/e në ZRPPC	7	60.5	20	2	16,940.00
Zyrtar i Administratës dhe Logjistikës në KKZ	7	60.5	45	2	38,115.00
Kontributet Pensionale të Punedhënesit			402		17,293.93

Total**363,172.43**

Lista e Anetareve te KKZ-ve dhe Trajnerat per zgjedhjet e parakoheshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës

Pozita	Koeficienti	Vlera e koefic.	Numri	Muajt	Totali
Anëtar te KKZ	8	60.5	266	3	386,232.00
Trajnerët e KVV-ve	7.5	60.5	274	2	248,655.00
Kontributet Pensionale te Punëdhënësit			540		31,744.35
Total					666,631.35

Lista e Stafit ditor dhe KVV-ve per zgjedhjet e parakoheshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës

Pozita	Rundi	Mëditja	Numri	Ditët	Totali
Stafi i QNR-së (staf ditor)	1	25	285	11.3	80,512.50
Stafi i QNR-së (staf ditor)	1	22	400	11.3	99,440.00
Nëpunës te rezultateve preliminare K-Vote (900+20 Rezerv)	1	50	920	2	92,000.00
Kryesues i Vendvotimit	1	45	2700	3	364,500.00
Anëtarët e Vendvotimit	1	30	16800	3	1,512,000.00
Anetar Rezervë te Vendvotimit	1	22.5	2925	2	131,625.00
Zyrtar i Tavolinës Ndihmëse	1	18	2100	2	75,600.00
Menaxher te Qendres se Votimit	1	26.5	950	3	75,525.00
Asistent të QV-ve	1	16	1900	2	60,800.00
Punëtor Fizik	1	15	150	2	4,500.00
Pronar te kombibusit	1	50.5	1550	2	156,550.00
Kontributet Pensionale te Punedhenesit			30680		132,652.63
Total					2,785,705.13